



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, Datë 21.07.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E GODINËS SË RE TË  
PARABURGIMIT, BURG U 313”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin e Godinës së re të paraburgimit, Burgu 313”, Bashkia Tiranë, me subjekt aplikues Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe kërkues Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ndërtimi duhet t’i përshtatet rregullave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, bazuar në legjislacionin sektorial në fuqi.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
5. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
6. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT


EGLANTINA GJERMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



NASIP NAÇO

MINISTËR I DREJTËSISË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT